



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN	
01 Nr. / Br	143/21
Nr. i fq. / Br. sh	-6-
Data: / Datum	11.06.2021
VUSHTRRI - VUCITRN	



KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
17 maj 2021 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloi në ora 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Afrim Namani, nënkryetar i komunës, drejtorët e drejtorive (Arta Ismajli dhe Agron Përçuku), si dhe nga sekretaria e kuvendit Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – tha se materiali na ka ardhur vonë dhe ka qenë edhe periudhë festive dhe nuk kemi pasur mundësi ta shqyrtojmë dhe ta analizojmë.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së –deklaroi se përpos që është afati në planin e punës së kuvendit dhe shkresës që kryetari i komunës për drejtoritë që materialet të dorëzohen në sekretari deri më datën 5 të muajit, sekretaria e kuvendit çdo muaj ua rikujton drejtorëve të drejtorive lidhur me çështjet që janë të planifikuara në planin e punës.

Afrim Namani, nënkryetar i komunës – lidhur me qarkoren buxhetore ai deklaroi se sot në mëngjes ka ardhur.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 prill 2021;
2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren Buxhetore 2022 dhe miratimi i Planit të Veprimit për dëgjime publike;
4. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 prill 2021.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15 prill 2021.

2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se lidhur me listën e të propozuarve për mirënjohje që ka ardhur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka qenë pak në ngjarje dhe shumica e të propozuarve janë që t’iu ndahet mirënjohje pas vdekjes. Ai tha se kanë qenë edhe pesë propozime tjera në drejtori, por që zyrtarisht nuk na i kanë sjellë. Ai propozoi që të jetë në listë edhe Shaqir Musliu – ish veteran i luftës së UÇK-së, i cili ka vdekur nga Covid 19.

Jemi dëshmitar që kuvendi ka pasur raste që ka ndarë mirënjohje edhe më shumë se 10 dekorata (që parashihet me Rregulloren për Dekorata) dhe kur kemi raste specifike mund të bëjmë shmangien e kësaj rregulloreje sa i përket numrit për ndarjen e mirënjohjeve.. Prandaj, mund të ketë edhe propozime nga anëtarët e KPF-së, por edhe nga anëtarët e kuvendit. Nëse ne pajtohemi, mund t’i bëjmë dy lista për mirënjohje: Një listë e të gjallëve dhe një listë pas vdekjes dhe t’i procedojmë në kuvend dhe pastaj mos t’i fusim fare në vota por njëzëri t’i votojmë.

Klinaku deklaroi se duhet që të ndahet edhe titulli “Qytetar nderi” që nuk është propozuar nga qeveria komunale. Ai tha se ka një propozim lidhur me këtë.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së –theksoi se pajtohet me Nezirin lidhur me atë që tha se mund të ndajmë më shumë mirënjohje pasi që kemi pasur situatë të jashtëzakonshme si pasojë e Covid 19.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – deklaroi se është mirë që të pajtohemi dhe mos t’i fusim në votim, sepse të gjithë e meritojnë që t’iu ndahet mirënjohje, sepse, kur po i fusim në konkurrencë përmes votimit, ne si anëtarë të kuvendit po ndihemi keq për atë që nuk marrin vota sikur që nuk e meritojnë. Ai për mirënjohje pas vdekjes propozoi Ferki Rashicën, i cili ka dhënë kontribut për klubin “Kosova e Vushtrisë”.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – edhe unë pajtohem që bëjmë shmangie të rregullores dhe të kemi dy lista: Pas vdekjes t’iu ndahen 10 personaliteteve dhe 10 personaliteteve që janë gjallë t’iu ndahen mirënjohje. Ai tha pandemia Covid 19 ka goditur dhe ka marrë shumë jetë njerëzish, prandaj është mirë që për mirënjohje të përfshihen edhe të gjitha profesionet dhe lëmitë e ndryshme, e sidomos këta që janë gjallë. Sa i përket propozimeve që janë gjallë, ai tha se e kemi marrë materialin vonë dhe nuk kemi pasur shumë mundësi me analizu. Ai propozoi dy pjesëtarë të policisë që kanë marrë pjesë në aksionin për shuarjen e zjarrin në spitalin e Vushtrisë. Pasi që Vushtrria është vend bujqësor është mirë që të mendohet që edhe bujqve t’iu ndahet mirënjohje.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së –lidhur me intervenimin në spital ndoshta është mirë ta lëmë, sepse nuk i dimë specifikat dhe nuk e di a ka qenë aq kritike situata. Kurse, sa i përket fermerëve dhe bizneseve, kjo është dashur që gjithmonë të jetë pjesë strukturale e ndarjes së mirënjohjeve.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se drejtoresha e kulturës është dashur të jetë e pranishme në këtë mbledhje dhe të na jep sqarime lidhur me propozimet që kanë ardhur ose dikush nga

drejtoria. Ai kërkoi nga nënkryetari i komunës që ta thërras drejtoreshën apo dikë nga drejtoria që të vjen në mbledhje.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se edhe në mbledhjen e kuvendit do të ketë propozime dhe sikur të ishte drejtoresha këtu, ndoshta disa prej propozimeve do të reduktoheshin. Ajo tha se duhet ta merr dikush një çmim edhe që janë të fuqizuara si gra, ku kemi shumë prej tyre. Prandaj, ne mund të bëjmë propozime dhe nuk e dimë se a ka marrë më herët mirënjohje apo jo. Ajo tha se ka dy propozime për mirënjohje që janë personale: Zenel Bunjaku, i cili ka jep kontribut në zhvillimin e ekonomisë së vogël dhe bujqësisë dhe Flora Shabani, e cila është një grua shumë e zonja në biznes.

Prandaj, të dakordohemi si subjekte politike dhe t'i votojmë njëzëri në kuvend, sepse sot nuk kemi mundësi ta mbyllim listën, sepse edhe në kuvend mund të ketë propozime. Ne si KPF mund të dakordohemi që t'i kemi dy lista të mirënjohjeve: 10 pas vdekjes dhe 10 të personave që janë gjallë.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – më bëri përshtypje propozimi për titullin “Nderi i qytetit”, i cili propozim qenka bërë nga kryetari i komunës. Xhafer Tahiri garën për zgjedhje e ka fituar duke e nënçmuar punën e Bajram Mulakut, kurse tani e propozon për ndarjen e titullit “Nderi i qytetit”. Ne si lëvizje jemi që t'i shtojmë procedurat përpara për këtë çështje. Sa i përket propozimeve edhe unë pajtohem që të jenë dy lista për ndarje të mirënjohjeve: Pas vdekjes dhe personave që janë gjallë. Edhe pse nuk është konsultuar me subjektin e saj, ajo propozoi për mirënjohje Ajmane Feratin – punëtore e komunës, për të cilën kam respekt dhe e cila ka dhënë kontribut. Ajo është familjare e një martiri dhe është anëtare e shoqatës së martirëve. Fatkeqësisht kohën e fundit është diagnostifikuar me kancer dhe mendoj që e meriton një mirënjohje prej komunës për kontributin që e ka dhënë prej vitesh.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – para vdekjes ka marrë mirënjohje Safet Idrizi, por pasi që pas vdekjes është mirënjohje tjetër e kisha propozuar për mirënjohje Dr. Safet Idrizin.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se ka punuar shumë në rregulloren për dekorata dhe mendoj se është e njëjta mirënjohje si para vdekjes. Në rregullore ceket se nëse një person ka marrë një herë mirënjohje nuk mund të merr përsëri.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – propozoi për mirënjohje pas vdekjes Jusuf Hajredinaj, i cili ka qenë edhe drejtor dhe zv/drejtor në shkollë dhe mësimdhënës i gjuhës shqipe. Ai në vitin 2017 në shkollën “Migjeni” vdes me ditë në dorë.

Arta Ismajli, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – pa dashur që të ndërhyj lidhur me atë që u diskutua këtu, me qenë kryesuese e përzgjedhjes së personave për mirënjohje vërtet është privilegj, por që i ka edhe vështirësitë e veta. Lidhur me propozimin e Ymerit për Jusuf Hajredinaj, ajo tha se si propozim ka ardhë në drejtori, por që komisioni i ka përzgjedh dy nga pesë propozimet nga fusha e arsimit që kanë vdekur në vendin e punës. Po ashtu, dy propozimet janë përzgjedh edhe nga fusha e shëndetësisë.

Ajo tha se kjo listë e të propozuarve është nga drejtoria bashkë me komisionin.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – duke e pasur parasysh që edhe çmimi “Qytetar nderi” është shumë i rëndësishëm për Ditën e Çlirimit të Komunës së Vushtrrisë kam një propozim konkret.

Pas konsultave me shumë shokë të luftës, propozimi im është për Enver Oruçajn – ish komandant i Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës të UÇK-së.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren Buxhetore 2022 dhe miratimi i Planit të Veprimit për dëgjime publike.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që Qarkorja Buxhetore 2022 së bashku me planin për dëgjimet buxhetore të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme.

Drita Dibrani, kryetare e KVRL-së – kërkoi që në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport t’iu mundësohet një nënkod buxhetor për rininë. Ajo tha se është hera e tretë që e ka ngritur këtë shqetësim. Por, tani është koha, sepse janë dëgjimet buxhetore dhe bëhet planifikimi i buxhetit për vitin 2022. Në pamundësi për t’u takuar me drejtoreshën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e shfrytëzova këtë mundësi ta paraqes si kërkesë.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së –tha se si KPF mund ta nxjerrim një konkluzion ose një rekomandim për Drejtorinë e Financave që e përkrahim këtë kërkesë

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që të na vjen në mbledhje të kuvendit se deri ku ka shkuar procesi i rimëkëmbjes ekonomike.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – ka qenë një rekomandim i kuvendit që deri më datën 15 maj të kryhen procedurat për pranimin e punëtorëve të sigurimit dhe pastrimit në ndërmarrjen e re “Përparimi”. Deri sot ende nuk u janë nënshkruar kontratat këtyre punëtorëve. Deri ku ka shkuar ky proces, pse ka ngel?

Ai tha se këto ditë ka parë që ka pasur reagime edhe rreth disa tubimeve që po organizohen rreth vaksinimit, por atë ditë kuvendi i komunës ka qenë arenë e shkeljes së të gjitha masave anti – covid. Por, nuk ka pasur asnjë reagim nga kryetari i komunës e as nga drejtori i inspekcionit, kurse tani përmes facebookut dalin dhe e lavdërojnë punën e një drejtorie apo drejtorie tjetër.

Afrim Namani, nënkryetar i komunës – tha se që nga mëngjesi jemi duke u marrë me marrëveshjen që duhet të lidhet në mes komunës dhe ndërmarrjes “Përparimi”. Është një marrëveshje që po lidhet për herë të parë dhe duhet shumë modalitete dhe besoj që deri në fund të javës do të përfundojë gjithçka. Ai tha se edhe propoganda është duke punuar shumë, sepse gjoja një punëtor ka qenë tek unë në zyre, e kinse unë i paskam thënë që do të mbetet pa paga 3-4 muaj. Se kush po merret me këtë, le të mbetet në ndërgjegjen e tyre, por jo unë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – ne si kuvend kemi rekomanduar që gjatë kohës kur të shpallet konkursi, t'i kenë parasysh punëtorët aktual. Por, ata të cilët nuk i plotësojnë kushtet, nuk do të mundet bordi i drejtorëve t'i merr në punë. Ju jeni zotuar që deri me 15 maj me përfundim marrëveshjen. Edhe pse jeni vonuar pak s'ka lidhje, por janë procedurat tjera për rekrutim, që do të stërzgaten, sepse ligji nuk e lejon ndryshe.

Afrim Namani, nënkryetar i komunës – arsyeja pse është shtyrë janë gjashtë raste të punëtorëve të sigurimit fizik që kanë disa telashe.

Agron Përçuku, drejtor i Drejtorisë për Inspektim – tha se procedura e vaksinimit ka qenë për krejt Kosovën, e jo vetëm për Vushtrri. Kanë qenë disa persona që janë munduar t'i dezinformojnë qytetarët dhe të shfaqin panik dhe probleme të vaksinimit.

Lidhur me masat anticovid në sallën e kuvendit për mua ka qenë befasi, unë nuk e di kush i ka nxit punëtorët. Ka pasur edhe protesta tjera, por jo çdo herë si inspeksion mund të jemi në vendin e ngjarjes dhe t'i përcjellim procedurat dhe vendimet e qeverisë, por aq sa po mundemi po i përcjellim masat, por edhe qytetarët janë vetëdijësuar.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – theksoi se nuk dua ta mbroj Agronin, por është një nga drejtorët që më së shumti e ka respektuar punën e vet, duke i respektuar trupat e kuvendit dhe asnjëherë nuk ka tentuar të bëjë politikë.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – Agroni doli në një temë tjetër, por unë e kisha fjalën për grumbullimin e njerëzve në sallën e kuvendit komunal. Atë ditë në sallë, kishte shkelje flagrante të të gjitha masave anticovid dhe asnjëri nga anëtarët e kuvendit nuk kanë postuar ndonjë foto, sepse kemi dashur ta ruajmë rolin e kuvendit. Prandaj, me pasë ndodhë kjo ishin marrë edhe mediat me neve. Prandaj, asnjë reagim nuk ka ndodhur as nga kryetari, as nga ju e as nga ne si opozitë. Dëshiroj që kjo ngjarje mos të përsëritet asnjëherë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se sipas rregullores për punë të kuvendit, kryesuesi i kuvendit është kompetent që në bashkëpunim me partitë politike vendosin për largimin apo jo të mysafirëve në sallë. Qytetarin nuk mund ta ndalojë drejtori i inspeksionit, prandaj mos t'i përzieri kompetencat.


Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – deklaroi se atë ditë unë kam kërkuar që 1-3 përfaqësues të punëtorëve mund të qëndrojnë në sallë (këtë mund ta gjeni edhe në transkript), por dikur situata doli jashtë kontrollit dhe sjelljet e punëtorëve ndaj anëtarëve të kuvendit dhe të tjerëve nuk ishin të hjeshme. Por, kryetari i komunës bërë një gabim që ju tha hyni dhe dëgjoni, pastaj salla u mbush plot me punëtorë.

Arta Ismajli, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – po më vjen mirë që po e takoj Dritën. Kemi mundur të takohemi jo vetëm brenda orarit prej 8 orësh, por edhe brenda 24 orësh. Po më vjen keq për atë që tha Drita se s'kam pasur mundësi ta takoj drejtoreshën. Kam takuar edhe njerëz krejt të thjeshtë që kanë kërkuar takim, brenda kësaj periudhe aq të shkurtër (2 muaj) prej që jam në drejtori. Ti ke qenë në zyrën e Burim Rexhepit që është afër me zyren time dhe këtë e kam ditur. E kam pasur në agjendë dhe e kam që të takoj edhe ty sikurse shumicën e sportistëve dhe organizatave joqeveritare. Takim nuk ke kërkuar me mua, sepse kam qenë dhe jam e hapur për takime. Pavarësisht këtyre, unë të përgëzoj për punën që e ke bërë dhe je duke

bërë dhe nuk kam asgjë personale. Prandaj, e përkrahu këtë kërkesë dhe jam që të shtyhet përpara, e cila është dashur të ndodhë shumë më herët. Ndarja e një vije buxhetore është gjëja më e mirë që mundet me ndodhë për rininë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës

Nasuf Alin


Kryesues i KK-së dhe i KPF- së